



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I MURALEVE MURAL FEST

Memorandum bashkëpunimi

I lidhur në mes OJQ "MURAL FEST" me seli në rr."Latif Hasani"p.n. Ferizaj, Kosovë dhe Komunës së Gjakovës.

Arsyetim:

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të rinjëve në komunën e Gjakovës, si dhe duke synuar në gjithpërfshirjen e të gjithë krijuesve të rinjë të kësaj komune, Mural Fest e ka parë të nevojshme që të fuqizojë këtë Memorandum Bashkëpunimi i cili do të ndikonte në rritjen e vetëdijes qytetare nëpërmjet aktiviteteve artistike që zhvillon Mural Fest.

Mural Fest dhe Komuna e Gjakovës janë dakorduar që ky Memorandum Bashkëpunimi të ketë kushtet e mëposhtme:

1. Për të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen në qytetin e Gjakovës, Mural Fest do të bëjë publikimin e konkursit edhe për krijuesit e komunës së Gjakovës. Ky konkurs duhet të publikohet edhe në faqen e Komunës përkatese;
2. Aktivitetet që zhvillon Mural Fest, do të jenë në favor të artistëve të Gjakovës, veçanërisht atyre që kanë talent në fushën e artit u jep mundësi të shprehin talentin e tyre.
3. Komuna e Gjakovës do të bashkëpunojë me Mural Fest si në perkrashjen organizative për eventet artistike si: konkurse, ekspozita apo edhe murale.
4. Punimet më të dalluara artistike, të përzgjedhura nga komisioni profesionist i MURAL FEST mund të ekspozohen, publikohen apo edhe të realizohen si murale.
5. Mural Fest ndër të tjera do ta vendosë logon e Komunës së Gjakovës në një pjesë të faqes së organizatës online;
6. Memorandumi i bashkëpunimit nënshkruhet në afat një vjeçar dhe i njëjti mund të ketë ri vazhdim automatik edhe për një vit nëse palët nuk kanë ndonjë kundërshtim;
7. Në rast se njëra palë dëshiron të shkëputë bashkëpunimin atëherë obligohet që në afat prej 10 ditësh ta njoftoj palën tjetër për ndërprerjen e Memorandumit;
8. Ky dokument nuk përmban asnjë obligim financiar për asnjërën palë.

Për: MURAL FEST,

Lebibe Topalli-Shabani

Drejtor ekzekutiv i Mural Fest

Email: info@murfest.org

Data/vendi _____ / _____

Për: Komunën e Gjakovës

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

email: ardian.gjini@rks-gov.net

Data/vendi 05/05/2021 / Gjakovë

